



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 7.6.2022, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i programit të punimeve për periudhën 30 maj-1 korrik 2022.
2. Miratimi i procesverbaleve të zbardhura për mbledhjet e komisionit të datave 25 dhe 29 mars, si dhe 9, 10, 11, 16 dhe 17 maj 2022.
3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të aktit normativ nr. 9, datë 11.5.2022 “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”.
4. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë””.
5. Miratimi i draft-rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të AMF-së për vitin 2021

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi dhe Etjen Xhafaj.

**Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj, Agron Shehi dhe Jorida Tabaku.

**Të ftuar:**

Delina Ibrahimaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Adela Xhemali - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili - Drejtore e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi - Drejtore, Drejtorja e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit, Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Sajmir Muçmataj - Drejtor, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Idlir Gjata – Këshilltar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Evis Fico - Këshilltare pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Vjollca Braho – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna – Drejtore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Mejvis Kola – Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

Saimir Kadiu – Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Para se të fillojmë mbledhjen, verifikojmë kuorumin. Kuorumi është në rregull.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e programit të punimeve për periudhën 30 maj-1 korrik 2022. Jeni dakord?

Në rregull.

Miratimin e procesverbaleve të zbardhura për mbledhjet e komisionit të datave 25 dhe 29 mars, si dhe të mbledhjeve 9,10, 11, 16 dhe 17 maj.

A keni ndonjë gjë për procesverbalet?

Nuk ka.

Miratohen edhe procesverbalet.

Si pikë tjetër kemi shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës të aktit normativ nr. 9, datë 11.5.2022 “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”. Relatore është zonja Antoneta Dhima.

Më pas kemi shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë””. Relatore është zonja Enslevera Zake.

Në mbyllje kemi miratimin e draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të AMF-së (Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare) për vitin 2021.

Për aktin normativ nr. 9, kemi të ftuar përfaqësues së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ministren Delina Ibrahimaj, zonja Kesjana Halili, zoti Nikolla Lera, zonja Brikena Jazxhi, zoti Sajmir Muçmataj dhe zoti Ildir Gjata, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Pa humbur kohë fjalën po ia jap ministres.

Më pas do të kemi pyetje dhe diskutime për të kaluar në miratim.

Fjala për ju zonja Ministre.

**Delina Ibrahimaj** – Përshëndetje!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Qëllimi projektligjit “Për një shtesë në ligjin 41/2022 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg””, është për të mundësuar një element suportues për subjektet që i nënshtrohen masave me karakter detyrues të përcaktuara në këtë ligji, konkretisht detyrimit për mbajtjen e rezervave të produkteve për një periudhë 3- mujore.

Situata emergjente e krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar ka ardhur si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar dhe e ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen dhe rregullimin e kësaj situatë me anë të këtij akti normativ.

Konkretisht, në projektligj synohet mbështetja me një garanci shtetërore nga e cila mund të përfitojnë subjektet që tregtojnë produkte me shumicë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave. Në kushtet kur masa për mbajtjen e një rezerve 3-mujore të produkteve do të kërkonte një likuiditet të konsiderueshëm, dhënia e një garancie shtetërore, e cila do të rriste aksesin në financim të këtyre subjekteve pranë sistemit tonë bankar, u vlerësua si një mekanizëm i nevojshëm për implementimin sa më me efektivitet të kësaj mase të parashikuar.

Ky ndryshim i propozuar në vetvete nuk ka efekt financiar në buxhetin e shtetit. Garancia shtetërore që do të lëshohet, do t’u nënshtrohet procedurave dhe miratimeve, sipas legjisllacionit në fuqi. Konkretisht, garancia shtetërore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas vijohet me lidhjen e marrëveshjeve të veçanta nga ministri i Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Fjalën e ka zonja Dhima në cilësinë e relatores.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin e aktit normativ!

Në fakt, ne si komision para disa muajve kemi miratuar aktin normativ nr. 7 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg” dhe sot do të miratojmë një shtesë me aktin normativ nr. 9, për këtë akt normativ, që e kemi miratuar më parë.

Qëllimi i këtij aktiv normativ është t'u mundësojë subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë mbajtjen e rezervave, sipas përcaktimeve të aktit normativ nr. 7, duke autorizuar Këshillin e Ministrave që të miratojë garanci shtetërore të huasë me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve dhe të përcaktojë kushtet dhe kriteret e marrëveshjes tip të garancisë dhe të marrëveshjes tip të mirëkuptimit.

Akti është hartuar në përputhje me Kushtetutën dhe me nenin 101 të saj, i cili i ka parashikuar të drejtën Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullative me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe njëkohësisht të urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

Akti normativ nr. 7, të cilin e kemi miratuar në datën 18.3.2021, në nenin 8 të pikës 2, përcakton detyrimin që të gjitha subjektet, objekt i tij, që tregtojnë produkte me shumicë të nevojshme për furnizimin e popullatës, të marrim masa për mbajtjen e rezervës të produkteve që tregtojnë për një periudhë 3-mujore, me qëllim përballimin e situatës të veçantë të krijuar në treg nga rritja e menjëhershme e çmimeve. Meqenëse gjatë zbatimit të këtij akti normativ është konstatuar se një pjesë e mirë e subjekteve, që e mbartin këtë detyrim, nuk i kanë mundësitë dhe likuiditetet e nevojshme për krijimin e kësaj rezerve, Këshilli i Ministrave ka miratuar një ndryshim në aktin normativ nr. 7, duke krijuar një mekanizëm, nëpërmjet të cilit i jepet mundësia këtyre subjekteve për të përfituar garanci shtetërore, e cila do të rrisë aksesin e tyre në financimin pranë sistemit bankar.

Por, duke qenë se dhënia e një garancie shtetërore implementohet bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon dhënien e miratimit nga ministri i Financave pas një procedure aplikimi pranë kësaj ministrie, e cila mund të zgjasë deri në 6 muaj, periudhë, e cila e tejkalon periudhën 3-mujore të detyrimit të vendosur në aktin normativ nr. 7, qeveria nëpërmjet aktit normativ nr. 9, të cilin po e diskutojmë, synon të bëjë një rregullim të përkohshëm të situatës, duke autorizuar Këshillin e Ministrave të përcaktojë kushtet dhe kriteret e marrëveshjes së garancisë, duke bërë të mundur që kërkesat për hua nga subjektet t'u drejtohen direkt bankave të nivelit të dytë dhe miratimi i tyre do të realizohet nga këto të fundit brenda një periudhe shumë të shkurtër në përputhje me marrëveshjen e garancisë tip të miratuar.

Sigurisht, ky është një rregullim i përkohshëm i diktuar nga kushtet e urgjencës si rezultat i situatës së krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar dhe nga nevojat për të rregulluar situatën dhe mundësuar subjektet në zbatimin e

detyrimet ligjor për krijimin e rezervave ushqimore, i cili do të jetë në fuqi deri në miratimin e ndryshimeve të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, që do t’i shndërrojë në instrumente të përhershëm financimi këto skema garancie.

Ashtu sikurse e tha edhe ministrja në fjalën e saj, akti normativ nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit. Garancia shtetërore që do të lëshohet do t’u nënshtrohet procedurave dhe miratimeve, sipas legjislacionit në fuqi. Duke vlerësuar rëndësinë që ka miratimi i këtij ndryshimi në mënyrë që të bëhet e mundur përmbushja e detyrimeve të subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të krijuar një rezervë 3-mujore ushqimore, i ftoj të gjithë kolegët që ta miratojmë këtë akt normativ.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Dhima!

Hapim debatin.

Kush ka pyetje?

Po, zoti Braçe.

Zonja Koliqi, keni pyetje apo diskutim?

Pyetje.

**Erion Braçe** – Kam një pyetje. Kjo garancia shtetërore për të krijuar këtë depozitën e vendosur me ligj për 3 muaj, është vetëm për 4 produktet e shportës apo edhe të tjera? E para.

E dyta, kjo do të funksionojë vetëm për importin apo edhe për prodhimin vendas, pra për të grumbulluar nga prodhimi vendas?

**Eduard Shalsi** – Fjalën e ka zonja Koliqi.

Më pas fjalën e kanë zoti Sinaj dhe zoti Xhelili.

**Emilja Koliqi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Jemi në fillim të qershorit dhe deri sot janë depozituar 10 akte normative në Kuvend. Cila është arsyeja që qeveria punon me akte normative në një kohë që parlamenti vazhdon punën normalisht dhe nuk ka asnjë pengesë për shqyrtimin e projektligjeve?

Në relacionin e projektaktit ju thoni se për këto skema garancie nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë përgatitur edhe ndryshimet ligjore në ligjin nr. 9665 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, për t’i pasur si instrument të përhershëm financimi. Ju shpreheni: “Kjo iniciativë ligjore është aktualisht në proces konsultimi”. Pse nuk sillen këto ndryshime në parlament? Ju

keni tashmë një eksperiencë, rasti i Covid-it, ku në vitin 2020 janë hartuar 2 akte normative për garancitë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve. A nuk mjaftojnë këto 2 vjet për të paraqitur ndryshimet ligjore në Kuvend dhe për të vijuar rrugën normale të miratimit dhe mospërdorimit të akteve normative?

Ju thoni që ky projektakt është me urgjencë. Cila është urgjenca, kur ne dimë që rritja e çmimeve ka filluar që nga vjeshta e vitit të kaluar dhe akti normativ nr. 7 është miratuar që në muajin mars dhe aktualisht, sipas rrjeteve të supermarketeve, kërkesa për mallrat e shportës është stabilizuar pas mbingopjes së konsumatorit me produkte ushqimore, madje ata parashikojnë një zbritje në shitjen e tyre. Qëllimi i këtij akti është për të mundësuar mbajtjen e rezervave, sipas parashikimit të aktit normativ nr. 7, për të gjitha subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, por garantimi i rezervave për popullsinë është një detyrë e qeverisë, e cila nuk po e kryen, por po ia ngarkon bizneseve dhe subjekteve që merren me tregtimin e artikujve. Pse nuk paraqitet ligji për rezervat e sigurisë në një kohë që ka pasur një projektligj që nga viti 2019, i cili është paraqitur për konsultim, por nuk ka ardhur në parlament? Unë mendoj se qeveria u bën presion bizneseve që të marrin hua, por në qoftë se mungojnë paratë, si do t'i shlyejnë ata huatë që do të marrin?

Në zbatim të këtij akti normativ ju keni paraqitur edhe vendimin e Këshillit të Ministrave, ku shuma e përgjithshme e garancisë është 3 miliardë lekë.

E para, si është konkluduar për shifrën 3 miliardë? Sa është numri i subjekteve që do të përfitojnë? Pse janë përfshirë vetëm 4 banka në aktmarrëveshje dhe nuk janë përfshirë të gjithë bankat që operojnë në Shqipëri?

Pyetja tjetër: a ka ndër mend qeveria të mundësojë për bizneset kredi me interes zero? Sa është masa e garancisë për këtë huamarrje?

Në lidhje me shpërndarjen e garancisë sovrane për rastin e Covid-it janë bërë dy shpërndarje, shpërndarja 1 dhe 2, kështu që do të doja të dija sa ka qenë e suksesshme kjo shpërndarje e garancisë (në rastin e parë ka qenë 11 miliardë lekë dhe në rastin e dytë ka qenë 15 miliardë lekë)? Sa ka qenë numri i bizneseve përfitues dhe shuma e huave për të cilën ata kanë aplikuar nëpër banka?

Ju thoni që nuk ka efekt në buxhetin e shtetit, por ku është parashikuar si zë buxhetor kjo garanci prej 3 miliardë lekësh?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Fjalën e ka zoti Sinaj.

Më pas zoti Xhelili dhe do të mbyllim pjesën e parë të pyetjeve.

**Vullnet Sinaj** – Do të doja të dija: a ka një vlerë tavan kjo garancia që do të sigurojnë bankat e nivelit të dytë për t'i financuar këto biznese, pra a do të ketë një tavan të caktuar për garancinë?

Faleminderit!

**Alban Xhelili** – Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ishte e lidhur edhe me pyetjet e kolegëve. Dua të di: sa është konsumi 3-mujor për këta 4 artikuj, pra miellin, sheqerin, vajin dhe orizin dhe nëse kjo garanci do t'i përfshijë këto produkte?

Pyetja tjetër ka të bëjë me pyetjen që bëri zonja Koliqi, lidhur me vlerën 3 miliardë lekë të garancisë, pra rezerva 3-mujore është rreth kësaj shifre. Aktualisht sa është rezerva e këtyre produkteve?

Lidhur me rezervën është bërë ky parashikim, pra në aktin normativ është vetëm me rezervën e 4 artikujve, por edhe brenda këtyre për ata që është përcaktuar çmim, pra për të gjithë miellin dhe për atë që shitet me një çmim tjetër?

Po dal pak nga tema, kjo garanci përngjan pak me garancinë sovraane në kushtet e mëparshme. Dua të di ajo garanci sovraane u shfrytëzua dhe sa u shfrytëzua? Pra, dua të di nëse ajo garanci do të ketë efekt dhe nëse do të përdoret apo jo?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zoti Xhelili!

Zonja Ministre, fjala për ju.

**Delina Ibrahimaj** – Faleminderit për pyetjet!

Pyetja e parë ishte se cilat produkte mbulon garancia. Garancia mbulon produkte, të cilat me vendim bordi kanë hyrë në monitorimin e transparencës së çmimeve, pra grurë, miell, vaj luledielli, sheqer dhe oriz. Sigurisht që garancia mbulon blerjet, pra nuk kufizohet në import, por kufizohet në fatura blerjesh.

Sa u takon pyetjeve dhe komenteve të zonjës Koliqi, po filloj me urgjencën dhe pse kalojnë me akte normative dhe nuk kalojnë me procese ligjore normale.

Në kushtet kur u mor vendimi për krijimin e bordeve, ishin kushte emergjente dhe ku çmimet po rriteshin në mënyrë të përshpejtuar, dua të theksoj se rritja e çmimeve në Shqipëri është përshpejtuar gjatë muajve mars, prill dhe maj, ndërkohë që gjatë vitit të kaluar, ndryshe nga vendet e tjera të botës, ne kemi pasur inflacion stabil nën traqetin e Bankës së Shqipërisë.

Pra, urgjenca vinte nga situata emergjente që ishte krijuar, nga nevoja për të ndërhyrë me qëllim moslejimin e spekulimeve mbi çmimin, pra moslejimin e materializimit të rritjes së



çmimeve para se kostot realisht të ishin rritur, e cila në një situatë normale është një dukuri normale, njihet nga të gjithë ekonomistët pritet inflacioniste dhe ndikimi që pritet inflacioniste kanë në çmim aktual para se kostot realisht të materializohen të rritura. Por, duke qenë një situatë e veçantë ne vendosëm të krijojmë bordin me qëllim që kjo dukuri, krejt normale në një ekonomi tregu, të mos materializohet tek ne.

Ju thoni që kërkesa është materializuar dhe çfarë nevojë ka kur kjo kërkesë është materializuar. Në fakt, sugjerimi për aktin normativ vjen si masë mbështetëse, si ndihmë shtetërore që i jepet këtij sektori të caktuar për të garantuar blerjen e rezervës. Nuk është hera e parë që qeveria kalon një akt normativ, i cili detyron mbajtjen e rezervave të caktuara. Edhe në aktin që kaloi gjatë periudhës së pandemisë ne shprehëm detyrimin për të mbajtur një rezervë të përcaktuar, duke qenë në kushtet e pasigurisë. Ndryshe nga atëherë çmimet janë rritur ndjeshëm dhe ne propozojmë këtë akt me qëllimin për t'u ardhur në ndihmë tregtarëve dhe që të garantojnë mbajtjen e rezervës.

U bënë pyetje mbi nivelin e disbursimit të kredive të garancive sovrane të mëparshme. Nga të dyja garancitë sovrane, garancitë nr. 1 dhe nr. 2, kanë përfituar rreth 1100 tatimpagues-biznese. Janë 492 kredi të miratuara nga garancia sovrane nr. 1 dhe 607 kredi të miratuara nga garancia sovrane nr. 2.

Në nivel përdorimi të fondit të vënë në dispozicion për garancitë kemi 54 % nivelin e përdorimit të garancisë nr. 1 dhe 73 % nivelin e përdorimit të garancisë nr. 2. Këto janë granci, pra janë kredi, të cilat biznesi i merr me kushte lehtësuese, duke qenë se përdoret fondi i garancisë sovrane për të mbuluar kolateralin. Gjithashtu, kushtet kanë qenë favorizuese, pasi normat e interesit kanë qenë më të ulëta sesa ato të tregut.

Zëri buxhetor ku parashikohet garancia sovrane ka të bëjë me ripagesat e mundshme të kredive në rast se ato shkojnë në mospagim, pra materializohen në kredi të këqija dhe sigurisht që kjo ndodh jo brenda harkut kohor të këtij viti. Masa që ne mbulojmë kolateralin nëpërmjet kësaj garancie është 60%, krijimi i rezervave, thashë nuk është hera e parë që përdoret ky instrument. Ne kemi vendosur të operojmë me 4 banka dhe, nëse do të kishim përfshirë të gjitha bankat, procesi do të bëhej shumë më i komplikuar, pasi janë bankat kryesore me të cilat tregtarët operojnë dhe kanë marrëdhënie në këtë sektor.

Numri i tregtarëve që operojnë me këto produkte është i kufizuar, janë rreth 18 tregtarë që operojnë në vaj, por 2 ose 3 prej tyre kanë 90% të tregut. Janë rreth 10 tregtarë në importin dhe përpunimin e miellit dhe të grurit dhe rreth 7-8 tregtarë në fushën e orizit dhe të sheqerit. Pra, numri i tyre është i kufizuar.

Ne dhe bizneset, gjithashtu, e përshëndesim këtë nismë dhe mendojmë se është një masë, që u vjen në ndihmë atyre, me qëllim garantimin e likuiditetit për furnizimin.

Ne nuk kemi një shifër në këtë moment se sa është rezerva aktuale e tyre, mund të marrim një informacion dhe t'ia paraqesim komisionit, megjithatë në takimet e herëpashershme që ne kryejmë për mbledhjet e bordit, në bashkëpunim me tregtarët, na kanë garantuar që, edhe në fillim të kësaj periudhe ata e kanë pasur rezervën 3-mujore. Nëpërmjet këtij instrumenti duhet të garantojmë që të vazhdojnë të blejnë dhe të ketë likuiditetet e duhura.

Në rast se nuk do të kenë mundësi shitje të këtyre produkteve, akti normativ përcakton se produkti do të blihet mbrapsht nga rezervat e shtetit. Në këtë pikëpamje bizneset janë totalisht të mbrojtura.

Besoj se i adresova të gjitha pyetjet e komisionit.

Kisha edhe diçka për të shtuar, që ka të bëjë me ligjin për Agjencinë e Trajtimit të Kredive. Ne jemi duke diskutuar ndryshimin e këtij ligji, i cili do të vijë në parlament dhe nuk do të kalojë në formën e një akti normativ, por si një proces ligjor normal, ku nuk parashikohet vetëm dhënia e garancive sovrane, por parashikohet që menaxhimi dhe ndjekja e garancive sovrane do të bëhet nga Agjencia e Trajtimit të Kredive. Pra, ligji nuk ka të bëjë vetëm me dhënien e mundësisë për dhënien e garancive sovrane, por ka edhe elemente të tjera, madje, në paralel me të do të ketë edhe një ndryshim në ligjin e bordit, pasi janë ligje që preken me këtë ndërhyrje. Sigurisht që do të vijë në parlament.

Për sa u përket rezervave të shtetit, ne kemi pasur edhe një interpelancë, ku është shpjeguar që procedurat e rezervave të shtetit dhe masat janë procese konfidenciale dhe vazhdojmë ta mbajmë këtë qëndrim.

**Eduard Shalsi** – Zoti Shehi, fjala për ju. Pastaj e kanë fjalën zonja Koliqi dhe zonja Denaj.

**Dashamir Shehi** – Sigurisht që në princip biem dakord, është situatë emergjence dhe brenda saj do të bëhen disa lëshime, madje si shifër, brenda Shqipërisë me emergjencën e këtyre dy vjetëve kemi kaluar shifra ku e ku, 30 milionë është e gjithë kjo histori, mirëpo ne jetojmë gjithnjë në një situatë permanente. Këtu u tha që kemi 10 akte normative, edhe vjet e kemi diskutuar këtë punë, që bëjnë 15 akte normative apo më tepër, kështu që unë them se kjo lloj historie duhet të mbarojë. A ka një rrugë tjetër për këtë punë? Sigurisht që ka. Po të ishim ngutur pak me atë ligjin, që të kishte një çadër të përgjithshme për këto çështje, sigurisht që do të ishte edhe më mirë.

Mua më shqetëson një gjë, unë kam frikë se kjo, si të gjitha këto historitë e mbështetjeve financiare, do të përfundojë në disa duar dhe kam frikë se është ndërtuar për disa duar, që do të thotë se këtë lloj tregtie apo biznesi te ne e bëjnë njerëz që shesin njëkohësisht edhe tulla, edhe naftë, edhe energji elektrike, po të njëjtët janë, po t'i shohësh, që blejnë grurin, vajin, sheqerin, miellin e orizin dhe kur këto nuk kanë likuiditete brenda grupit të madh, se nuk dua t'i them me emra, kur u mungon likuiditeti te karburanti, te tullat, te pallati e te hoteli që kanë filluar në Dhërmi, ngel puna, se nuk ecën pazari i sheqerit, orizit apo të tjera. Këtu duhen disa likuiditete pastaj që do t'i marrin këta, nuk është se ka për t'i dhënë ndonjë vrull të madh biznesit tregtar në përgjithësi, gjykoj unë dhe jam i sigurt, sikurse ju thashë edhe herën tjetër në parlament, që kur të mbarojë e gjithë kjo histori, do të shohim se 10 zengjinë janë bërë më zengjinë, dhe 200 biznesmenë të vegjël apo të mesëm do të jenë bërë pak më fukarenj. Ky është dyshimi im, por ju mund të mendoni ndryshe.

Unë mendoj edhe diçka tjetër, ne këtu si komision, ju si qeveri, në radhë të parë, shumë mirë që po mendoni t'i ndihmoni këta tregtarë, kjo është shumë gjë e mirë, jemi në emergjencë, por ejani të ndihmojmë edhe prodhuesit! Pse nuk bëjmë një skemë të tillë meqë vjen vjeshta e të mbillet grurë, të marrin kredi prodhuesit e grurit, të kishin marrë të misrit deri tani, prapë mund të mbjellim shumë e shumë gjëra. Unë nuk besoj se kjo krizë do të mbyllet. Ejani të vëmë jo 30 milionë, por të vëmë 100 milionë me garanci nga bankat, t'i fusim në lojë bankat dhe të fillojë të lëvizë prodhimi vendas. Këtë vit tokat do të punohen 20-25% më pak në kohën e krizës dhe ky muhabet do të vijë duke u ngushtuar, se i mungon një pjesë nga prodhimi vendas kësaj pune. Po për vete e ka vrarë mendjen njeri, që na duhet një skemë që të mbulojmë disa elemente të tjerë që ta vëmë në lëvizje mallin shqiptar, i cili do t'i zbritet këtij malli që është i rrezikshëm, se e prodhojmë këtu në Shqipëri dhe mund të na dalë me kosto edhe më të lirë? Por, edhe në qoftë se do të dalë aty-aty dhe në qoftë se do ta ketë pak më të lartë koston, unë them se ia vlen në këtë periudhë, se tani jemi duke vrarë mendjen nëse filani ka te depot e veta kaq muaj, aq muaj, kush do ta kontrollojë këtë lloj situatë. Domethënë, ne duhet të fusim në treg njëherë faktorin më të rëndësishëm, që është prodhimi lokal, pastaj do të mendojmë për tregtarët.

Jua thashë, nuk jam kundër, se zotëria pyete se sa zë kjo, kjo nuk zë asgjë, ju e dini fort mirë. Kjo është garancia që do të mbulohet. Ju e dini që importi i produkteve ushqimore në Shqipëri është me qindra, milionë. Këtë them unë, kjo është detyra jonë, makro, ju si qeveri dhe ne si komision t'u japim një mbështetje, të bëjmë gati një telajo legjislativë, që t'i qëndrojmë në këmbë kësaj krize, por që të jetë pak më afatgjatë. Ju do të vini sërish pas dy javësh apo pas një

muaji, se do të mungojë një mall tjetër brenda tregut. Në qoftë se e keni bërë për 4 mallra, nga vjeshta mund të dalin përpara emergjenca të tjera.

Ky është gjykimi im.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Koliqi, pastaj zoti Braçe.

**Emilja Koliqi** – Nga shifrat që dha zonja Ministre shihet që ndikimi për marrjen e kësaj garancie është më shumë e përfaqësuesve të bizneseve që janë edhe pjesë e bordeve të vendosjes së çmimeve.

Nga të 13 pjesëmarrësit, 7 janë nga qeveria dhe 6 janë përfaqësues të bizneseve, për më tepër u tha që janë 18 tregtarë dhe 2-3, të cilët zënë 90% të tregut të vajit në Shqipëri, 10 që kanë tregun e miellit dhe 7-8 të tjerë, pra një numër shumë i kufizuar, të cilët do të përfitojnë nga kjo garanci shtetërore, për më tepër kjo ndihmë do të jepet vetëm për rastet e bizneseve që janë afër qeverisë.

Për një pyetje tjetër që kisha, në qoftë se qeveria do të mundësojë që bizneset të marrin një kredi me interes zero, nuk mora një përgjigje.

Në lidhje me bordet, nga misioni i fundit i FMN-së u shprehën kundër bordeve dhe dhanë orientimin që Shqipëria të japë mbështetjen për përballimin e krizës me paketa ndihme për shtresat në nevojë në një kohë që Shqipëria është ndër vendet e fundit në rajon për paketat e ndihmës për shtresat në nevojë përveç Malit të Zi. Kur do të kalojmë ne në ekonominë e tregut? Kur do të përfundojnë këto borde, të cilat në vend që të lehtësojnë çmimet për popullsinë, përkundrazi po i rrisin përditë? Kjo ndoshta po kthehet edhe në një bumerang për ato biznese, të cilët tregtojnë në Shqipëri, pasi shumë individë po drejtohen drejt Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi për importe për blerje individuale, ndoshta edhe për blerje me pakicë, duke qenë se TVSH-ja është zero në Maqedoni dhe në Malin e Zi, dhe aty ka përfitime nga ana individuale.

Një kohë që opozita ka paraqitur disa herë kërkesën për uljen e TVSH-së së mallrave të shportës, asnjëherë nuk u pranua nga qeveria ulja e TVSH-së në një kohë që edhe vendet e rajonit, por më tepër edhe vendet e Europës kanë marrë masa për uljen e taksave për lehtësimin e popullsisë në kushtet e krizës ekonomike.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** - Zoti Braçe, pastaj zonja Denaj.

**Erion Braçe** – Unë do të rikthehem atje ku qëndrova edhe me pyetjen. Pa diskutim që ne nuk prodhojmë as vaj, as sheqer dhe as oriz, por drithëra prodhojmë, grurë, misër, gruri e ka vaktin tani, mistri në fund të gushtit dhe fillim të shtatorit bëhet edhe ai për t'u korrur dhe të

gjitha drithërat e tjera, që nga elbi e të gjitha drithërat e tjera. Fushat janë plot, pavarësisht rendimentit të tyre edhe për shkak të shtrenjtimit të kostove të punës, por edhe të plehrave kimike që mund të rrisin fare mirë rendimentet.

Kështu që, mendoj se qeveria duhet ta kishte pjesë të këtij akti, që të paktën për drithërat, këto kompanitë të detyroheshin të mblidhnin prodhimin vendas, madje me çmim të rregulluar për të mos thënë me çmim të kontrolluar.

Për shkak të atyre që thashë, çdo bujku i ka shkuar kostoja për dynym 20-22 mijë lekë, me çmimin e vjetshëm 28-30 lekë për kilogram, janë në humbje sot që flasim; me çmimin 35 lekë për kilogram, janë me humbje; me çmimin 40 lekë për kilogram, janë me humbje, po flas për grurin; me çmimin 50 lekë për kilogram, nxjerrin paratë e tyre, që do të thotë se do të ishte krejt normale që qeveria të bëjë një analizë të kostove të bujkut dhe të orientonte këto kompani të grumbullojnë prodhimin vendas jo ta konkurrojnë prodhimin vendas me prodhim importi. Është themelore në qoftë se ne duam që vitin tjetër të kemi grurë, që vitin tjetër të kemi misër, në qoftë se bujkut ne sot nuk i mbledhim prodhim që ai ka, aq sa ka, çdo gramë është i vlefshëm këtë vit edhe vitin tjetër, edhe subvencion t'i japim, vitin tjetër bujku nuk do të mbjellë. Pse? Sepse është pikërisht në këtë hallin e kostove që kanë shkuar lart dhe çmimeve që janë poshtë për bujkun tonë, jo çmimet në tregjet ndërkombëtare, se çmimi i grurit është i lartë edhe tani që po flasim, nuk ka çmimin e para dy javëve, por ka çmimin e para dy muajve dhe i justifikon të gjitha kostot e bujkut tonë.

Atëherë, në qoftë se ka një apel sot, që unë do të doja t'ia bëj qeverisë, është pikërisht kjo gjë, këtë garanci dhe këto kompani t'i orientojë te prodhimi vendas. Është momenti për të mbledhur, do të jenë 200 mijë tonë, do të jenë 250 mijë tonë saç kemi pasur një vit më parë, këtë s'jua them dot tani, se duhet parë rendimenti, por rendiment mbi 50 kuintalë grurë këtë vit nuk ka. Është gati 50% e konsumit tonë, kështu që do të jetë shumë e rëndësishme kjo gjë. E para.

E dyta, po qëndroj në të njëjtën pikë, ky akt normativ, por edhe ai i mëparshmi është orientuar thjesht dhe vetëm tek ushqimet bazë të shportës, në fakt duhet ta kishte bërë Ministria e Bujqësisë, por ne kemi edhe kafshë në prodhim, nuk po flas për kafshët shtëpiake që janë luks, pavarësisht se ka njerëz që i duan edhe më shumë se fëmijët e tyre, por po flas për kafshët në prodhim. Dakord, nuk rregullohet çmimi, hanë misër, hanë bullgur, hanë tërshërë, hanë çdo lloj gjëje ato kafshët, madje edhe bar po importohet nga jashtë, po mirë, për këto kafshët që prodhojnë qumësht, shpendët që prodhojnë vezë, mish, a nuk mund të vini në dispozicion një garanci apo të bëheshin pjesë e kësaj garancie sovrane, me qëllim që edhe ato të kenë mundësi të ushqehen? Ka shkuar një dëng bari me jonxhë 9 mijë lekë sot që flasim. Pra, propozimi i dytë që

kam është të përfshini brenda kësaj garancie, edhe ato kompani që garantojnë prodhim vendi, ushqim për kafshët por edhe importi po të doni, meqë ato hanë më shumë se njerëzit, po të doni.

E treta, unë do të vazhdoj të insistoj për plehrat kimike, jo thjesht dhe vetëm se të gjitha organizatat që merren me prodhimin bujqësor e kanë një pikë fokale, ku insistojnë pa fund duke filluar nga Banka Botërore që ka marrë fokusin kryesor te prodhimi i ushqimeve, por edhe për shkak se tregu në këtë vend jo vetëm që është i kapur, nuk kemi 7, 10 apo 18 tregtarë këtu, sipas Autoritetit të Konkurrencës janë vetëm 2. Banka Botërore kishte vetëm një thirrje, heqjen e barrierave dhe përdorimin efektiv i plehrave kimike, për të rritur rendimentet dhe për të pasur prodhim më të madh.

Është hera e dytë që ne vijmë me një akt normativ dhe përsëri, edhe pse angazhimi ka qenë publik, mbetet i pambajtur për të vënë nën kontroll çmimin e plehrave kimike. Tani nuk nevojiten, deri në gusht nuk duhen, por në shtator do të duhen prapë, se fillojnë mbjelljet e tjera. Atëherë, çfarë do të bëjmë? Në qoftë se sot është 130 mijë lekë kuintali i uresë, në shtator do të shkojë 200. Kosto janë këto. Te bujqit tanë, pjesa më e madhe janë të vegjël, kostot e tilla nxisin që të mos mbjellin.

E fundit që kam, nuk lidhet me këtë akt, por lidhet me aktin tjetër normativ. Çmimi i naftës po shkon si po shkon. Unë do të doja që këtij debati, veçanërisht me këtë shoqatën që funksionon si kartelë e hidrokarbureve, t'i japim fund. Duhet t'i jepni ju fund, duke analizuar një për një të gjitha shpenzimet e tyre.

Unë sot vij nga Veriu, kam që në mëngjes atje, dhe po ju them që ka pika të bardha apo të rrjeteve të vogla që po shesin jo me çmimin e bordit, por po shesin me 238, 239 lekë, ka që janë edhe me 236 lekë, pika të bardha. Këtu rikthehem te debati që kemi pasur, që një pjesë e shpenzimeve që shoqata, që funksionon si kartel pretendon, nuk janë te pikat ku pronësia është e vetë pronarit, pra kostot e qerasë, kostot e energjisë, kur nuk kanë kabinë elektrike më vete, ajo që ka një çmim tjetër, kosto të tjera operationale, kostot e punëtorëve, sigurime shoqërore e të tjera me radhë, nuk janë ato që pretendon shoqata kartel.

E dyta që kam, po prapë me naftën, keni 2 çmime në tabelë. Si pikat që janë të brenduara, edhe pikat e tjera të bardha kanë dy çmime në tabelë, një është çmimi që ka vendosur bordi 248 lekë sot, një çmim tjetër është 256 lekë që i referohet një super naftë që ka një cilësi e standard tjetër e kështu me radhë. Që të mos funksionojë kjo si te vaji i lulediellit që çfarë keni kontrolluar ju me shumë të drejtë, te vaji i misrit që është jashtë portës duke rritur çmimin, të mos ndodhë edhe tek nafta, që çfarë kontrolloni ju me çmimin e bordit, e kompensojnë ata me çmimin e naftës që është standard tjetër. Nuk është detyrë juaja, pa diskutim, por meqë jeni ju, në emër të

qeverisë, fokusi të jetë te cilësia e naftës. Është ai standardi vërtetë për 256 lekë? Është ai standardi vërtetë për 239 lekë? Është pjesë e konkurrencës edhe kjo.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Denaj, dhe përmbyllim.

**Anila Denaj** – Faleminderit, kryetar!

Doja të bëja vetëm dy komente, së pari, në raport me garancinë shtetërore, si një instrument gjerësisht i përdorur këto vitet e fundit, për të tejkaluar kriza, sigurisht, në qoftë se akti normativ është një formë juridike, që e ndihmon situatën, ashtu është, nuk dua të ngelemi te forma, por shkojmë te përmbajtja.

Garancia sovrane është përdorur si në kohën e pandemisë, edhe në kohën e tërmetit për të garantuar likuiditetet për bizneset dhe individët në kohë krize dhe kjo është një garanci tjetër sovrane në situatë jo të lehtë, le të themi, për të tejkaluar kështu që është më se e mirëpritur dhe jam në mbështetje të asaj që tha zoti Shehi që duhet të kemi një hapësirë më të gjerë në vlefta dhe në kohë, që të mos kthehemi në përsëritje. Ju mirëkuptojmë, ne jemi mbështetës të këtij instrumenti në kohë krize. Për këtë akt normativ kam vetëm një koment, nuk e shoh të arsyeshme limitimin në 4 banka, pasi mendoj se marrëdhënia me bankën që zgjedh biznesi është marrëdhënie shumë e gjerë dhe marrëdhënia e biznesit me bankën mund të ndryshojë gjatë një viti. Gjatë dy vjetësh dhe nuk është i detyruar asnjë biznes të rrijë më një bankë nëse kjo marrëdhënie ndryshon për arsye që e di vetë biznesi.

Megjithatë meqenëse është një situatë emergjente le të jetë e tillë, por në platformat e ardhshme do të duhet të ishte sa më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Ndërkohë unë do të kërkoja që duke shpresuar ta kalojmë këtë situatë të instrumenteve në momente krize, siç e thashë pak më parë, të shkojmë drejt një qasjeje më proaktive në afatmesëm. Ju e përmendët pak më parë edhe rolin që duhet të ketë ASD-ja, mund të jetë ajo ose jo, unë e mirëpres, sepse nuk mund të jetë më ministria që ta monitorojë këtë proces, por në momentin që bëni këto ndryshime ligjore dhe kushdo ent që do ta marrë përsipër, ju lutem, mendoni për instrumente më afatmesme për sektorë të rëndësishëm, siç janë: turizmi, bujqësia, eksportet, që të marrim benefitin e aksesit në financë me këto instrumente sa më shumë dhe më shpejt të jetë e mundur, sepse vetëm duke i dhënë një instrument afatmesëm dhe mbikëqyrjen e duhur ne do të tejkalojmë këtë situatë të zgjidhjes gjithmonë me akte normative dhe kriza. Kjo krizë mund të zgjasë më shumë se një vit, por të kemi një qasje proaktive dhe këtë do ta mirëprisnim, unë personalisht çdo propozim nga ana juaj brenda këtij viti në këtë aspekt.

**Eduard Shalsi** – Zoti Xhafaj

**Etjen Xhafaj** – Faleminderit!

Sa i përket trajtimit nga opozita të taksave sikur të jenë një padrejtësi e imponuar ndaj komunitetit kur ndërkohë ne e dimë se është praktikë mbarëbotërore dhe do të bënin mirë të gjithë të vlerësonin taksat për atë që janë në tërësinë e tyre dhe jo individualisht. Historiku i sistemit të taksa pagimit në Shqipëri është shumë i shkurtër dhe duhet që të dy palët, pavarësisht se kush është në pushtet, e vetmja mënyrë që financohet shteti është kjo.

Prandaj duhet ta mbështesim këtë sistem!

**Eduard Shalsi** – Para se të kalojmë në votim unë kam një gjë të shkurtër. Mbjaj mend që në kohën e pandemisë, (ministrja Denaj duhet ta kujtojë që ne thërritëm kompanitë e importit aso kohe dhe donim që t'i orientonim drejt prodhimit të grurit vendas), patëm një problem me TVSH-në atëherë, kush do ta paguante TVSH-në.

Së dyti, ka ardhur koha, kjo edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të hartojmë politikat e subvencioneve për këto lloj produktesh. Në Kosovë me sa jam në dijeni kanë dhënë toka me kusht që të mbjellin 1, 2 ose 3 produkte një nga të cilat është edhe gruri. Por ky është një debat që, në fakt, duhet të vijojë, sepse ndërthun disa institucione dhe do të duhet ta. Pra do të duhet njëherë e mirë të konkludojmë se çfarë është e arritshme për t'u bërë dhe çfarë jo.

Gjithsesi duke ju falënderuar për pyetjet, përgjigjet dhe diskutime, kalojmë në votim në parim aktin normativ.

Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

**Sekretare e Komisionit**  
**Enslmvera Zake**

**Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ**  
**Elvi Prifti**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 07.06.2022, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë”

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi, Etjen Xhafaj

**Mungouan:**

Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj, Agron Shehi, Jorida Tabaku,

**Të ftuar:**

Vjollca Braho – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Antoneta Njehrrera - Drejtor**

**Mejvis Kola – Drejtor**

**Saimir Kadiu – Drejtor**

**Eduard Shalsi** - Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës. Relatore është zonja Zake. Të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë kemi zonjën Vjollca Braho, zëvendësministre, zonjën Antoneta Njehrrera, zonjën Mejvis Kola, dhe zotin Saimir Kadiu.

Pa humbur kohë fjalën e ka zëvendësministrja.

Pastaj do të kalojmë te pyetjet dhe diskutimet.

Fjala për zëvendësministren.

**Vjollca Braho** - Faleminderit!

Ky projektligj synon ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Qëllimi i këtij projektligji është të kontribuojë për modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Marrëveshja e re do të garantojë vijueshmërinë e objektit tonë madhor për të transformuar sistemin tonë shëndetësor në një sistem të integruar harmonik të krahasueshëm dhe do të vendosë në qendër qytetarët.

Marrëveshja vjen në kuadër të pasojave të tërmetit të nëntori të vitit 2019, ku Banka Botërore u angazhua në mbështetje me verën e 25 milionë eurove për rindërtimin e objekteve shëndetësore në kuadër të programit të qeverisë 2021-2025, ku rindërtimi është një nga shtyllat kryesore të financimit dhe kjo kontratë do të hapë rrugën financimit të objekteve shëndetësore. Projekti financohet në masën 100% nga Banka Botërore përfshirë edhe taksat e lindura në territorin e Shqipërisë. Pra, nuk parashikohet rimbursimi i detyrimeve tatimore. Financimi shtesë në vlerën e 25 milionë eurove për projektin e përmirësimit të sistemit shëndetësor në Shqipëri do të mundësojë përshkallëzim të mëtejshëm të aktiviteteve të projekteve mëmë dhe do të sigurojë ndikim të drejtpërdrejtë te përfituesit dhe përmirësim të ofrimit të kujdesshëm spitalor në vend. Projekti përbëhet nga komponenti i parë që është përmirësimi i menaxhimit dhe infrastrukturës së spitaleve publike me një vlerë prej 18 milionë e 760 mijë euro; nga komponenti i dytë përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit shëndetësor për shërbimin spitalor në vlerën 4 milionë e 400 mijë euro; komponenti i tretë i monitorimit vlerësimi dhe menaxhimit të projektit në vlerën 900 mijë euro, si edhe fondi i kontigjencës. Ndërsa, sipas kategorive, alokimi i fondeve është i ndarë në punimet civile që zënë 55,6% kundrejt totalit, pra me një vlerë prej 13 milionë e 900 mijë euro për mallra në 35,6% ndaj totalit me një vlerë prej 8,9 milionë euro, si edhe shërbime konsulence, trajnime dhe kosto operative në një vlerë 2,2 milionë euro që zënë 8,8 % kundrejt totalit. Sa i përket komponentit të parë përmirësimit të menaxhimit të infrastrukturës spitalore, me një vlerë prej 13 milionë e 900 mijë euro, ne do të bëjmë të mundur rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në 5 spitale: të

spitalit të Krujës dhe Lezhës, të shërbimi të kardiologjisë në QSUT, të spitalit psikiatrik në QSUT, të spitalit të djegieve plastike në QSUT, si edhe blerjen e pajisjeve mjekësore, si edhe për mobilimin e këtyre 5 spitaleve që do të rikonstruktohen.

Gjithashtu, forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të sektorit të spitaleve publike do të realizohet duke përfshirë përditësimin e masterplanit ekzistues të spitaleve dhe rishikimin e kuadrit rregullator ligjor; kryerjen e një vlerësimi të menaxhimit aktual të qendrave spitalore universitare dhe rekomandime të përmirësimeve përkatëse; përditësimin e udhëzuesve klinikë dhe protokolleve për sëmundjet kronike prioritare; krijimin e llogarive kombëtare të shëndetit zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve komunikuese për informimin e publikut mbi reformat në spitale. Sa i përket komponentit të dytë me një vlerë prej 4,4 milionë euro ky aktivitet do të jetë vazhdim i aktiviteteve të mëparshme në sistemin e digjitalizimit e sistemit të informacionit në të gjitha spitalet rajonale.

Deri në fund të vitit do të përfundojmë me kredinë e parë. Ka përfunduar shtrirja e implementimit të këtij sistemi në Durrës dhe deri në fund të vitit do të përfundojë edhe në spitalet rajonale të Vlorës, Shkodrës dhe Elbasanit.

Me miratimin e kësaj kredie do të bëhet e mundur shtrirja e këtij sistemi dhe në 7 spitale rajonale, si: Dibër, Kukës, Berat, Gjirokastrë, Lezhë, Fier dhe Korçë. Nëpërmjet sistemit të formatizimit të menaxhimit shëndetësor ne do të garantojmë digjitalizimin e të gjitha proceseve të punës dokumenteve mjekësore si edhe një akses në kohë reale të kartelës elektronike shëndetësore të pacientit dhe historikut të diagnozave. Pra që në momentin që pacienti do të futet në spital dhe deri në momentin që do të dalë nga spitali çdo gjë do të jetë e dokumentuar dhe do të jetë në mënyrë digjitale e gjithë praktika dhe procedurat ku çdo qytetarë do të ketë edhe kartelën e vet elektronike me diagnozat, ilaçet dhe trajtimet që ka marrë gjatë kohës që aknë qëndruar në spital. Në këtë komponent financimi përfshihen edhe licencat e softuerëve dhe aktivitete për trajtime shtesë si edhe për blerjen e pajisjeve kompjuterike për këto 5 spitale për të cilat do të bëhet i mundur pjesa e implementimit të sistemit digjital

Gjithashtu, financimi shtesë do të mundësojë përshkallëzim të mëtejshëm të aktiviteteve të projektit mëmë dhe do të sigurojë ndikim të drejtpërdrejtë te përfituesit në përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor. Ne do të vijojmë të garantojmë që çdo qytetar të marrë shërbim shëndetësor të aksesueshëm dhe sa më afër qendrave të vendbanimit të tyre duke filluar nga diagnostikimi në kohë dhe me cilësi të aparaturave bio-mjekësore të standardeve më të mira të rritit të spitaleve tona publike. Sa i përket komponentit të tretë që përfshin shërbimet e konsulencës, trajnimet dhe kostot operative kur kostot operative zënë 8,8 %

pra janë më të ulëta në krahasim me kredinë e marrë më përpara. Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore që rrjedh nga masterplani i spitaleve si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri si edhe përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe të cilësisë së spitaleve.

Mbështetur në rezultat e projektit mëmë, si modernizimi i pajisjeve diagnostifikuese mjekësore në 11 spitalet rajonale, rikonstruksioni i spitalit pediatrik në spitalin “Nënë Tereza”, ku ka përfunduar faza e parë dhe ka filluar faza e dytë, në mesin e re të spitalit të Laçit dhe Kukësit aktivitetet do të parashikohen edhe nga financimi shtesë dhe do të përputhen plotësisht me agjendën e zgjeruar të reformës për përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të kujdesit spitalor.

Rezultatet e projektit mëmë kanë inkurajuar Ministrinë e Shëndetësisë në ndjekjen e një reforme më të thellë në nivelin e kujdesit, duke filluar me përmirësimin e kujdesit diagnostik, optimizimin e shërbimeve rajonale, transformimin e shërbimeve në spitalet e përzgjedhura bashkiake, si edhe përmirësimin e sistemit të informacionit spitalor në të gjitha spitalet rajonale.

**Eduard Shalsi**- Faleminderit!

Zonja Zake, e ka fjalën.

**Enslemvera Zake** – Faleminderit!

Ky projektligj është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe ne e shqyrtojmë në cilësinë e komisionit përgjegjës. I është referuar neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji është i bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Marrëveshja bazë, që është bërë në vitin 2015 nga Kuvendi, është miratuar me ligj për ratifikimin e marrëveshjes për përmirësimin e sistemit shëndetësor në vendin tonë. Vlera totale e financimit është parashikuar 36, 1 milionë euro, nga të cilat 32,1 milionë euro janë financim i Bankës Ndërkombëtare të Rindërtim dhe Zhvillim dhe 4 milionë euro bashkëfinancim i qeverisë shqiptare. Marrëveshja ka objekt përmirësimin e efikasitetit të kujdesit në disa nga spitalet e vendit, përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor dhe rritjen e aksesit financiar dhe shërbimeve shëndetësore dhe u arritën rezultate pozitive, siç ishte modernizimi i pajisjeve mjekësore diagnostifikuese në 11 spitale rajonale, rikonstruksioni i spitalit pediatrik në QSUT dhe ndërtimi i mesin e re të spitalit të Laçit.

Nevoja për këtë projektligj vjen si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë së popullsisë dhe në kushtet e një periudhe të gjatë të tranzicionit demografik, dhe epidemiologjik në vendin tonë që ka bërë të nevojshme kryerjen e reformave për përmirësimin e shërbimit shëndetësor publik dhe ekziston nevoja në vijim për thellimin e mëtejshëm të tyre.

Projektligji u bë i nevojshëm për të financuar rindërtimin e disa objekteve shëndetësore, të cilat kanë qenë të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, si edhe përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës spitalore dhe të informacionit shëndetësor. Marrëveshja është miratuar nga Këshilli i Ministrave që në mars të këtij viti dhe synon financimin shtesë të projektit. Financimi do të kruhet tërësisht nga Banka Botërore duke përfshirë edhe tarifën dhe taksat e lindura në territorin e vendit tonë. Vlera e huas është 25 milionë euro, interesi është bazuar në normën e referencës plus një marzh të pandryshueshëm, Komisioni i angazhimit është 0,25 % mbi vlerën e pa disbursuar të huas, maturimi është 12 vjet, duke përfshirë periudhën prej 3,5 vitesh pa pagesë principali. Punimet kryesore që do të realizohen me anë të këtij projekti, së pari është përmirësimi i menaxhimit të infrastrukturës spitalore dhe në këtë drejtim parashikohet përditësimi masterplanit ekzistues të spitaleve dhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, duke synuar përmirësimin e planifikimit të shërbimeve të shpërndarjes së burimeve. Gjithashtu, synohet përmirësimi i menaxhimit të QSUT-së; përmirësimi i menaxhimit të informacionit shëndetësor dhe monitorimi i vlerësimit dhe menaxhimit të projektit.

Ky sistem monitorimi do të kryhet nga Ministria e Shëndetësisë, e cila do të ngrëjë një njësi specifike. Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është deri në datën 31 dhjetor 2024.

Projektligji është në përputhje me dy nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm: objektivi tre, që është sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit dhe objektivi 9, ndërtimi i infrastrukturave rezistuese.

Kjo është një risi që na vjen edhe nga relacionet që na përgatitin edhe ministritë pasi ne kemi ngritur nënkomisionin për zhvillimin e objektivave të qëndrueshme që drejtohet nga zonaj Denaj. Tani çdo projektligj do të na vijë duke synuar dhe cilësuar cilin objektiv përafrohet ose përputhet.

Ftoj anëtarët e komisionit ta miratojmë këtë projektligj.

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Para se të kalojmë në votim a ka ndonjë pyetje? Po, zoti Agalliu, pastaj zonja Dhima dhe zoti Sinaj.

**Arbi Agalliu** – Unë kisha një pyetje për normën e interesit të kësaj huaje. Nuk kam arritur ta gjej, ose më saktë në materialin që unë disponoj nuk e kam. Sa është norma e interesit?

**Vjollca Braho** – Në relacion është thënë që norma e interesit e kësaj kredie përcaktohet në momentin e disbursimit sikurse është e përcaktuar për të gjitha kreditë. Aktualisht euribori është negativ, sikurse etha dhe relatorja, është në vlerën minus 0,068% euribori 5 mujor. Mbi këtë normë shtohet marzhi referencë e përcaktuar nga Banka Botërore, që është 0,53%. Pra, në

total norma e interesit të kësaj kredie është 0,25 % dhe është kredi me norma shumë të ulëta deri në 0,5 % nëse disbursohet.

**Antoneta Dhima** - Në fakt, shëndetësia, si shumë sektorë të tjerë në këto vite qeverisjeje, është mbështetur financiarisht dhe ka realizuar ndërhyrje të rëndësishme në rehabilitimin e objekteve dhe ndërtimin e objekteve të reja, si dhe në qendra shëndetësore, njëkohësisht, në trajnimin e personelit shëndetësor dhe në specializimin e tyre. Edhe kjo marrëveshje, që po diskutojmë sot, ka të bëjë me një financim shtesë, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e monitorimit të menaxhimit të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit nëpërmjet përmirësimit të sistemit të informacionit, menaxhimit shëndetësor, sistemit të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore. Kjo shtesë e këtij financimi do të adresojë dhe integrimin gjinor dhe pilotimin e mekanizmave të llogaridhënies sociale, bazuar te pacientët.

Unë kam dy pyetje në lidhje me këtë marrëveshje. Së pari, në fjalën tuaj dhe në relacionin, që shoqëron projektligjin, janë 3 komponentë që janë përshkruar në shtesën e kredisë dhe një nga këta komponentë është sistemi i informacionit shëndetësor: cilat janë disa nga risitë që do të sjellë zbatimi i kësaj marrëveshjeje? Me anë të kësaj kredie do të bëhet fuqizimi i spitaleve rajonale: si do të realizohet fuqizimi dhe ku konsiston fuqizimi i këtyre spitaleve nga ana juaj nëpërmjet zbatimit të marrëveshjes dhe nëpërmjet këtij financimi shtesë?

**Eduard Shalsi** – Zoti Sinaj.

**Vullnet Sinaj** – Sa më shumë investim për mjekësinë, aq më mirë është, sepse ka të bëjë direkt me shëndetin e qytetarëve. Jam dakord me ato që thuhet në relacion dhe për miratimin e projektligjit.

Kam një pyetje. Nuk pashë në relacion investime për onkologjikun, është një nga shërbimet më delikate, ku shumica e njerëzve vuajnë, madje me pasoja të rënda të humbjes së jetës së të afërmeve të tyre. A keni parashikuar ndonjë investim për spitalin onkologjik, për aparaturat apo informatizimin e të dhënave të të sëmurëve të këtij spitali? A keni parashikuar një investim në gjithë këtë program për këtë spital, pasi këtu “shakatë” janë të vogla, sepse janë baras me jetën e njerëzve?

**Eduard Shalsi** – Po, zonja Zëvendësministre, fjala për ju.

**Vjollca Braho** – Në lidhje me pyetjen e zonjës Dhima për sa i përket procesit të informatizimit të sistemit, kjo është realizuar, sikurse e shpjegova edhe në materialin tim, dhe përfundon në fund të vitit në 4 spitale. Ka përfunduar në spitalin rajonal të Durrësit dhe po shtrihet në spitalin e Shkodrës, atë të Elbasanit dhe atë të Vlorës. Nëpërmjet këtij sistemi do të bëhet e mundur të shtrihet në të gjitha spitalet rajonale, në të 11 spitalet, procesi i digjitalizimit

për të garantuar që të kemi një informacion të hollësishëm për çdo pacient, i cili hyn, merr shërbim spitalor. Në të gjitha spitalet rajonale do të bëhet i mundur i gjithë dokumentacioni mjekësor që të kemi akses në kohë reale, nëpërmjet kartelës elektronike shëndetësore për çdo pacient, njëkohësisht, të shënojmë edhe diagnostikimin që është bërë për çdo pacient, çfarë ilaçesh ka marrë, çfarë diagnoze ka përcaktuar, në mënyrë që të kemi informacion të hollësishëm. Kjo është realizuar për 4 spitale dhe do të shtrihet nëpërmjet miratimit të kësaj huaje që do të bëhet sot nga ana juaj. Do të shtrihet procesi i digjitalizimit edhe në spitalet rajonale të Dibrës, të Kukësit, të Beratit, të Gjirokastrës, të Lezhës, të Fierit dhe të Korçës. Pra, nëpërmjet kësaj huaje do të bëhet e mundur mbyllja e të gjithë sistemit HIS, sistemit të informatizimit, ku do ta realizojmë në kohë reale.

Për sa i përket procesit të spitalit onkologjik, me këtë hua që jemi duke miratuar sot, e përcaktova se ku do të jenë ndërhyrjet kryesore; do të jenë ato spitale që kanë pasur dëme nga tërmeti i vitit 2019 dhe sistemi i informatizimit do të shtrihet në spitalet rajonale. Sigurisht që në vëmendjen tonë është i gjithë procesi dhe spitali onkologjik, ku është kryer investimi, është bërë një spital model, atje ku merret i gjithë shërbimi onkologjik nga ana e qytetarëve. Do ta kemi në fokusin tonë në vijim për ta rritur akoma më shumë cilësinë e shërbimit shëndetësor të spitaleve tona, qoftë në spitalet rajonale, qoftë edhe në spitalet universitare.

**Eduard Shalsi** – Përpara se të kalojmë në votim, kam një shënim nga Shërbimi i Kuvendit lidhur me anekset 3, 4 dhe 5 të marrëveshjeve. Nuk e di nëse jeni në dijeni, janë variante në anglisht, por nuk janë në shqip, përgatitja e plotë e marrëveshjes duhet të jetë në të dyja gjuhët. Prandaj, do t'u lutesha shërbimeve të Kuvendit që së bashku me përfaqësuesit e ministrisë të sigurojnë që marrëveshja të jetë e plotë në të gjitha komponentët.

Kishit diçka?

**Vjollca Braho** – Në këtë fazë, pra që ka ardhur marrëveshja për ratifikim, është e plotë edhe në gjuhën angleze, edhe atë shqipe, por çështja ka qenë për pjesën e miratimit në parim. Ato kanë qenë anekse në fazën e ratifikimit, nuk janë më. Është procedurë normale që ligji “Për marrëveshjet ndërkombëtare” i lejon. Unë po komunikoj edhe me këshilltarët e komisionit për t'i sqaruar.

**Eduard Shalsi** – Gjithsesi, nga pikëpamja e teknikës legislative do të komunikoni me këshilltarët e komisionit. Ka edhe një informacion nga një deputet për zbatimin e projektit aktual. Nëse jeni në dijeni, thjesht do t'ju vendosim materialin në dispozicion: arritjet dhe problematikat.

Atëherë, e përmbyllim çështjen e parafundit të rendit të ditës për sot.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Duke ju falënderuar, ju uroj punë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e Komisionit  
Ensemvera Zake**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve  
Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ  
Elvi Prifti**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 07.06.2022, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Miratimi i draftrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të AMF-së për vitin 2021.

**Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Edmond Spaho, Bujar Leskaj, Ilir Topi, Etjen Xhafaj.

**Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Pranvera Resulaj, Alfred Rushaj, Agron Shehaj, Jorida Tabaku.

**Eduard Shalsi** – Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës: rezoluta e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. A kanë kolegët ndonjë sugjerim, koment? Nuk kanë. Dakord.

Atëherë, në seancën e ditës së enjte raporton edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Kemi një kërkesë nga Shoqata e Kursim-Kreditit. Mund ta bëjmë formale, mund ta bëjmë informale, duhet të rakordojmë me një datë javën që vjen. Ka disa shqetësime nga disa institucione, kemi kërkuar edhe me Bankën e Shqipërisë që të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E thashë, të dyja format janë të aplikueshme.

Duke ju falënderuar, rishihemi të enjten në seancën plenare.

Mbledhjet e komisionit do t'i vijojmë javën tjetër.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e Komisionit**  
**Ensemvera Zake**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ**  
**Elvi Prifti**